

RREGULLA MBI ETIKEN PROFESIONALE

VLERESUESIT E DEMEVE NE SIGURIME

KREU I PARË PARIME THEMELORE

Neni 1 Percaktimi

Rregullat mbi etiken profesionale te vlerësuesit të licensuar të dëmeve në sigurime perfaqesojne nje teresi parimesh etike dhe profesionale, te cilat duhet te respektohen nga subjektet e licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) gjate ushtrimit te profesionit.

Vlerësuesit e licensuar të dëmeve në sigurime jane te detyruar te njohin dhe zbatojne gjate kryerjes se veprimtarise se tyre, parimet dhe rregullat qe permbahen ne kete dokument.

Këto rregulla janë të domosdoshme dhe i pashmangshme në profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime. Këto rregulla mund të klasifikohen në dy drejtime themelore:

1. Rregulla dhe parime që kanë të bëjnë me standardet e ushtrimit të profesionit të vlerësuesit të dëmeve në sigurime, si dhe
2. Rregulla te mirësjelljes, të cilat përcaktojnë normat dhe standardet e sjelles së vlerësuesit të dëmeve në sigurime gjatë ushtrimit të aktivitetit të vet.

Këto rregulla, së bashku me Kornizën e Praktikës profesionale dhe bazen ligjore qe rregullojne veprimtarine e vlerësuesit te dëmeve në sigurime plotesojne figuren profesionale te vleresuesit ne sherbim te konsumatorit te policave te sigurimit.

Neni 2 Qëllimi

Rregullat e etikes së vlerësuesit të licensuar të dëmeve në sigurime kanë për qëllim:

- Të promovojë një kulturë etike në ushtrimin e profesionit të vlerësuesit të dëmeve në sigurime;
- Të vendosin standarde për një sjellje etike dhe komunikim të hapur midis vlerësuesit të dëmeve në sigurime, shoqerive të sigurimit, risigurimit dhe ndaj klientëve;
- Të krijojnë besimin tek konsumatori se vlerësuesi i dëmeve do veprojë në mënyrë të paanëshme dhe të arsyeshme në gjithë veprimtarinë e vet me shoqëritë e sigurimit, risigurimit, institucionet publike apo me klientët e vet;
- Të forcojnë besimin e klientëve, shoqerive të sigurimit, risigurimit për një vlerësim të pavarur në tërësi;
- Të rritin praninë dhe reputacionin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime;
- Të promovojnë përgjegjshmërinë, transparencën dhe profesionalizmin në biznesin e vlerësimit të dëmeve në sigurime.

Neni 3 FUSHA E VEPRIMIT

Rregullat e etikës duhet të zbatohen nga personat fizik apo juridik të cilet kryejnë detyrën e vlerësuesit të dëmeve në sigurime .

Thyerja e rregullave të etikës nga ana e personave të mësipërm, të licensuar nga Autoriteti (AMF) do të jetë subjekt i masave në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Fakti se ndonjë sjellje e caktuar nuk është e përmendur në “Rregullat e Etikës” e cila mund të jetë e papranueshme apo e palejueshme nuk i mbron ata, prandaj nga ana e personave të mësipërm të licensuar nga Autoriteti (AMF) do të mbahet përgjegjësi për veprime disiplinore.

KREU I DYTË

PARIMET MBI STANDARTET PROFESIONALE

Nga ana e vlerësuesve të dëmeve në sigurime kërkohet zbatimi i parimeve vijuese.

Integriteti

Një vlerësues dëmsh në sigurime duhet të jetë i drejtë dhe i sinqertë në kryerjen e shërbimeve profesionale.

Integriteti i vlerësuesëve të dëmeve në sigurime krijon besim dhe është bazë për besueshmëri në vleresimet e kryera nga ana e tyre.

Objektiviteti

Një vlerësues dëmsh në sigurime duhet të shfaqë shkallën më të lartë të objektivitetit profesional gjatë grumbullimit, vlerësimit dhe paraqitjes së informacioneve në lidhje me veprimtarinë e procesit të vlerësimit.

Një vlerësues i dëmeve në sigurime bën vlerësim real dhe të harmonizuar të të gjitha kushteve dhe rrethanave përkatëse duke përgatitur çfarëdo ndikimi të padrejtë të interesave personale apo të të tjerëve gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

Një vlerësues dëmsh në sigurime nuk duhet të lejojë paragjykimet, konflikte të interesit apo ndikimin e të tjerëve të pengojnë gjykimin e tij profesional apo afarist.

Besueshmëria

Një vlerësues dëmsh në sigurime duhet të respektojë besimin e informacionit që merret si rezultat i marrëdhënieve profesionale e afariste dhe nuk duhet t'ia japë këtë informacion palës së tretë pa aprovimin e duhur dhe të veçantë, përveç rasteve kur ekziston e drejta ligjore, profesionale apo detyrim për ta paraqitur një informacion të tillë.

Informacionet e besuara, të marrura si rezultat i marrëdhënieve profesionale dhe afariste nuk duhen të përdoren për përparësi personale të vlerësuesit të dëmeve në sigurime apo palës së tretë.

Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur

Një vlerësues dëmsh në sigurime përdor njohuritë, shkathtësitë dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e shërbimeve që përputhen me natyrën e punës së tij.

Një vlerësues dëmsh në sigurime profesionist ka për detyrë të vazhdueshme të përmirësojë njohuritë e tij profesionale dhe aftësitë në një nivel të nevojshëm me qëllim që të garantojë klientet apo punëdhënësit shërbime kompetente profesionale bazuar në zhvillimet aktuale bashkëkohore.

Një vlerësues dëmsh në sigurime duhet të veprojë me kujdes dhe në përputhje me standardet e aplikuara teknike dhe profesionale kur ofron shërbime profesionale.

Mirësjellja profesionale

Një vlerësues dëmsh në sigurime profesionist duhet të veproj në pajtueshmëri me ligjet vendimet, rregullat në fuqi dhe duhet të mënjanojë çfarëdo veprimi që diskrediton profesionin e tij.

KREU I TRETË

RREGULLAT E MIRËSJELLJES SË VLERESUESIT TË DEMEVE NE SIGURIME

Integriteti

Vleresuesi i demeve duhet të kryejë punën e vet me ndershmëri, kujdes dhe përgjegjësi.

Duhet të zbatojë me perpikmeri ligjet, rregulloret dhe udhëzimet perkatese dhe veprimet duhet t'i kryejnë me profesionalizem, ne perputhje me bazen ligjore ne fuqi.

Nuk duhet që me dashje të jenë pjesë e çfarëdo veprimi joligjor, apo të kryejnë veprime që janë në kundërshtim me profesionin e vlerësuesëve të dëmeve në sigurime, palen e trete apo shoqërinë e sigurimit.

Duhet të respektojë dhe të kontribojë në synimet e pranueshme dhe etike të shoqërisë së sigurimit, pa cënuar interesat e palës së tretë.

Nuk duhet te veproje arbitrarisht ne dem te nje personi ose organizate dhe duhet te tregojte respektin e duhur per te drejtat dhe interesat personale te te treteve.

Objektiviteti

Vleresuesi i demeve ne sigurime nuk duhet të jetë pjesëmarrës i çfarëdo veprimtarie apo krijimit te cfaredo raporti, me pasojë dëmtimin e vlerësimit të paanshëm. Në pjesëmarrje nënkuptohen edhe veprimet apo raportet të cilat bien ndesh me interesat e shoqërisë së sigurimit apo palës së tretë.

Nuk duhet të pranojë asgjë që mund apo të nënkuptojë dëmtim të gjykimit të tij profesional.

Duhet të shpalosi të gjitha informacionet apo faktet materiale për të cilat është në dijeni, për llojet dhe hollesitë e shërbimeve që kryhen, nëse ato nuk shpalosen atëherë mund të shtrembërojë vlerësimin objektiv të dëmit.

Duhet të udhëhiqet nga rregulli që kërkuesi duhet të marrë dëmshpërblimin që meriton, edhe kur ai pretendon më pak, për shkak të njohurive të pamjaftueshme rreth rregullave për zhdëmtim apo për arsye të tjera.

Besueshmëria

Vlerësuesi i dëmeve në sigurime duhet të jetë i matur gjatë përdorimit të normave, standarteve apo kritereve të kërkuara gjatë ushtrimit të detyrave të tij.

Nuk duhet të përdore informata për kurrfarë përfitimi personal apo në ndonjë mënyrë tjetër e cila është në kundërshtim me ligjin apo e dëmshme për synimet etike të shoqërive të sigurimit apo palës së tretë.

Duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".

Kompetenca

Vlerësuesi i dëmeve në sigurime duhet të angazhohet vetëm në punët për të cilat posedojnë njohuri, shkathtësi dhe eksperience profesionale të nevojshme.

Duhet të kryejë veprimtarinë e tij në përputhje me ligjet për praktikën profesionale të vlerësuesit të dëmeve në sigurime.

Vazhdimisht duhet të përmirësojë profesionalizmin, shkathtësitë, efektshmërinë si dhe cilësinë e punës së tij.

KREU I KATËRTË

KUSHTET E USHTRIMIT TË PROFESIONIT

Vlerësuesi i dëmeve në sigurime para se të ushtrojë këto aktivitete duhet që të zbatojë kushtet e mëposhtme:

- Të jetë i pajisur me licencën e ushtrimit të profesionit nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF).

- Te plotesoje dhe te zbatoje kriteret e vendosura ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 164 dt 28.01.2008.
- Te zbatoje te gjitha ligjet, vendimet, rregulloret, udhezimet qe jane ne fuqi gjate ushtrimit te veprimtarise se tij.
- Te marre pjese ne trajnime te organizuara per ngritjen profesionale.
- Te jete ne kontakt te vazhdueshen me te rejat e fundit te teknologjise bashkekoheore ne lidhje me profesionin e tij ne menyre qe te jete i mireinformuar profesionalisht si dhe te ruaje formim te perhershem.
- Te mos ndermarre inisiativa apo sjellje, qe mund te kufizojne apo ndalojne te drejten e klienteve per zgjedhje te lire te vlerësuesit te dëmeve në sigurime.
- Te ruaje dhe mirembaje per aq sa e detyron ligji, gjithë dokumentacionin e veprimtarise se tij duke evituar cdo abuzim, mashtrim apo falsifikim, te cilat me apo pa qellim, denohen me ligj.
- Te evidentojte te gjitha ankesat e klienteve duke u dhene pergjigjet e duhura ligjore ankesave te bera nga ana e tyre.
- Ne ushtrimin e aktivitetit te tij duhet te kete nje mjedis te pershtatshem, infrastrukturen dhe mjetet e nevojeshme teknike.